

NDIKIMI I SJELLJEVE TË PAPËRSHTATSHME TË FËMIJËVE ME AUTIZËM NË
NIVELIN E STRESIT DHE DEPRESIONIT TEK PRINDËRIT E TYRE

MASTER I ARTEVE NË PSIKOLOGJI KLINIKE DHE E SHËNDETIT

NGA

SUNITA KURTI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË
PRISHTINË

2021

EKspoze e Temës

NDIKIMI I SJELLJEVE TË PAPËRSHTATSHME TË FËMIJËVE ME AUTIZËM NË NIVELIN E STRESIT DHE DEPRESIONIT TEK PRINDËRIT E TYRE

Mentor: Prof. Asoc. Zamira Hyseni

Kandidat: Sunita Kurti

Ky hulumtim i realizuar për të mbrojtur titullin Master i Psikologjisë Klinike dhe Shëndetit, është i tipit cross sectional me model kuantitativ, pra është një hulumtim që bazohet në pyetjet kërkimore dhe përdor instrumente të strukturuar. Mostra përbëhet prej 74 prindërve/kujdestarëve të fëmijëve të diagnostifikuar apo të dyshuar për autizëm që trajtohen në njërin nga degët e shoqatës Autizmi në Prishtinë, Pejë dhe Podujevë.

Punimi me titull “Ndikimi i sjelljeve të papërshtatshme të fëmijëve me autizëm në nivelin e stresit dhe depresionit tek prindërit e tyre” është realizuar me qëllim që të tregohet ndikimi i sjelljeve problematike që shfaqin fëmijët me autizëm në stresin e prindërimit, të hulumtohet për ndërlidhjen që mund të ketë stresi i prindërimit në paraqitjen e simptomave të depresionit, ankthit dhe stresit tek prindërit e fëmijëve me autizëm në Kosovë të cilat elemente mund të ndikojnë që prindërimi i personave me autizëm të mos jetë efektiv dhe aq dinamik sa duhet të jetë, (i formës së pranimit të realitetit të çrregullimit dhe kërkimit të trajtimit për fëmijët e tyre) ku si pasojë kemi fëmijë me autizëm me sjellje agresive dhe jo funksional.

Të dhënat statistikore, tregojnë se numri i personave të diagnostifikuar me Çrregullimin e Spektrit të autizmit, në botë, është rritur drastikisht në 40 vitete e fundit.

Çrregullimi i Spektrit të Autizmit është çrregullim neurozhvillimor i cili karakterizohet me vështirësi në komunikim, krijimin e lidhjeve shoqërore dhe shfaqjen e sjelljeve përsëritese dhe rigjide. Stresi i prindërimit që përjetojnë prindërit e personave me aftësi të kufizuara dallon nga ai i fëmijëve me zhvillim tipik. Janë bërë shumë studime që kanë vërtetuar praninë e stresit të prindërimit me daljen në sipërfaqe të sfidave të ndryshme që konsistojnë me fazat e zhvillimit të fëmijut me autizëm. Prindërimi i fëmijëve me autizëm tregon për shkallë sinjifikante të stresit të prindërimit tek prindërit e personave me autizëm gjë që ndikon në shfaqjen e niveleve të larta

të stresit, ankthit dhe depresionit. Dallimi gjinor sa i përket shfaqjes së nivelit të stresit është pasqyruar me nivele më të larta të stresit të përjetuar nga nënat e fëmijëve me autizëm. Nuk është vërejtur dallim gjinor të shfaqja e simptomave të depresionit. Është vërejtur ndërlidhje të rëndësishme mes pranimi nga ana e prindërve të elementeve të autizmit tek fëmija i tyre dhe mungesës së sjelljeve agresive tek ata, gjë që ka lënë hapësirë të interpretimit se pranimi i diagnozës ka bërë që prindërit të punojnë me fëmijët e tyre dhe tu ndihmojnë atyre të jenë më funksional.

Roli i rëndësishëm është parë se luajnë edhe të ardhurat mujore të familjeve në sjelljet problematike të fëmijëve, ku familjet me të ardhura më të vogla se mesatarja e pagës në Kosovë del se kanë fëmijë me autizëm me më tepër sjellje problematike sesa familjet me të ardhura mesatare.

Kjo lë hapësirë të interpretimit se familjet me mirëqenie më të mirë ekonomike kanë mundësi t'i trajtojnë në mënyrë profesionale fëmijët e tyre me autizëm. Implikimet praktike të këtij studimi në territorin e Kosovës tregojnë për nevojën që të përkrahen familjet e personave me autizëm në aspektin financiar por edhe të sigurimit të shërbimeve të shëndetit mendor.

Gjetjet e këtij studimi mund të ndikojnë në zhvillimin e praktikave pozitive të përballjes së përditshme me autizmin, duke intensifikuar kampanjat vetëdijësuese dhe ndryshimit të politikave sociale për familjet e personave me autizëm.

